REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno / Prodato / Recieved / Delivery	29.03.2023		vitit / god / year
Organ / Njesia / Organ / Jedinica / Org. Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKONSHCK	3129/2023		1.1

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE
SAVET KOSOVA ZA KULTURNO NASLEĐE
KOSOVO COUNCIL FOR THE CULTURAL HERITAGE

Pranuar / Dorezuar / Primljeno / Prodato / Recieved / Delivery	10/03/23		
Organ/Njesia / Organ/Jedinica / Org/Unit	Nr.Prot / Br.Prot / Prot.No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
	10/23		

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

VM/2023
Datë: 29/03/2023

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafi 1.6, nenit 20 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, nenit 14 paragrafi 1 të Rregullore Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e tretë (III) të mbajtur më datë 21.03.2023 dhe të vazhduar më datë 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.
2. Obligohet Kryetarja e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprime për zbatimin e rekomandimit të dhënë në raport.
3. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO · KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS · NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA · INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Jeton KOÇA

Kryetar i KPMShCK-së

Vendimi i dërgohet

- *Kryetares së Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore; dhe*
- *Arkivit të KPMShCK-së;*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivety	29.03	202 3	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org.Unit	Nr.Prot Br.Prot Prot.No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KKPMSHCK	3129	/2023	1/12

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT TË JASHTËZAKONSHËM PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

KËSHILLIN E KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net

HYRJE 3

BAZA LIGJORE 4

RAPORT PËR MONITORIMIN E JASHTËZAKONSHËM NË 5

GJENDJA E FAKTEVE 7

KONSTATIMET 10

REKOMANDIMET 12

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net

HYRJE

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, bënë monitorim të jashtëzakonshëm në rastet kur Këshilli konsideron së janë bërë shkelje të legjislacionit të shërbimit civil. Në këtë rast, Znj. Eliza Hoxha Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për monitorim të jashtëzakonshëm lidhur me caktimin e Zëvendësuesit të pozitës së Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka aprovuar kërkesën e Znj.Eliza Hoxha-Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e procedurës së monitorimit të jashtëzakonshëm lidhur me ligjshmërinë e vendimit për caktimin e zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore me Vendimin me Nr.02/2022 dhe ka emëruar Kolegjin për Monitorim të Jashtëzakonshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore duke e obliguar që të bëjë monitorim të jashtëzakonshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Kolegji i caktuar për monitorim të jashtëzakonshëm ka njoftuar Kryetaren e Bordit dhe Zyrtaren e Personelit për vizitën monitoruese në këtë institucion.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck rks-gov net

BAZA LIGJORE PËR MONITORIM TË JASHTËZAKONSHËM

Këshilli funksionin e monitorimit jashtëzakonshëm e ushtron mbi bazën e autorizimit ligjor të përcaktuar me nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.48/2018 për Monitorimin e Institucioneve të Administratës Publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të Shërbimit Civil.

Sipas nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil: *Këshilli, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka të drejtë që për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil. 2. Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil. 3. Anëtari i Këshillit është i obliguar që të paraqet raportin me të gjetura dhe rekomandime në mbledhjen e Këshillit dhe të jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli. 4. Këshilli, pas shqyrtimit të raportit nxjerr vendim, të cilin së bashku me raportin ia dërgon institucionit përkatës. 5. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.*

Neni 6 i Rregullores Nr.48/2018 për Monitorimin e Institucioneve të Administratës Publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të Shërbimit Civil përcakton: *1. Monitorimi i jashtëzakonshëm realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen më shkelje të rënda të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike.....3, kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm ka te drejtë të parashtroj: 31. Kryetari apo anëtari i Këshillit; 3.2 Zyrtari Kryesor Administrativ i Institucionit Përkatës; 3.3 Së paku pesë (5) nëpunës civil të institucionit përkatës; 3.4 Institucionet kompetente për zbatimi të ligjit dhe 3.5 Deputetët ë Kuvendit të Republikës së Kosovës...*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net

RAPORT PËR MONITORIMIN E JASHTËZAKONSHËM NË KËSHILLIN E KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të jashtëzakonshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Kryetarja e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur caktimin e zëvendësuesit Udhëheqës Ekzekutiv, ka marr këto prova:

- Korrespodenca me e-mail i datës 09.09.2021 në mes Kryetares së Bordit dhe z.Arton Smaili;
- Ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit për vendin e punës "Zyrtar Kryesor Financiar" e datës 08.12.20211;
- Akt emërimi për vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore" e datës 07.06.2019;
- Akt emërimi për vendin e punës "Zyrtar i Lartë i Personelit" i datës 11.03.2021;
- Akt emërimi për vendin e punës "Nëpunëse e Lartë për Koordinim, Teknik, Informim dhe Marrëdhënie me Publikun" e datës 01.01.2011;
- Akt emërimi për vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme" e datës 07.04.2021;
- Ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit për vendin e punës "Udhëheqës i Departamentit të Administratës/Menaxhere e Personelit" e datës 01.09.2015;
- Akt emërimi për vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore" e datës 03.12.2018;
- Akt emërimi për vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore" e datës 07.06.2019;
- Akt emërimi për vendin e punës "Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale" e datës 09.09.2021;
- Akt emërimi për vendin e punës "Zyrtare Administrative" e datës 01.09.2021;
- Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2020;
- E-mail i datës 01.09.2021 nga z.Isuf Koca;
- Formulari i shpenzimit të Departamentit e datës 26.10.2021;
- E-mail i datës 31.12.2021 nga z.Hilmi Demolli;
- E-mail i datës 21.01.20222 nga znj.Shehrie Leci;

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck rks-gov net

- Vendimi i datës 09.09.2021 për emërimin e z.Isuf Koca në pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale;
- E-mail i datës 09.09.2021 nga z.Arton Smaili;
- Vendimi i datës 22.02.2021 për Themelimin e Komisionit Vlerësues për Lëvizjen Brenda Kategorisë së Shërbimit Civil;
- Vendim i datës 13.09.2021 për caktimin e zëvendësuesit për vendin e punës Udhëheqës Ekzekutiv;
- Vendimi i datës 13.09.2021 për shpalljen e konkursit për pozitën Udhëheqës Ekzekutiv;
- Vendimi me numër A.nr.257/2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Urdhri për përmbarim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cp.nr.1516/18 i datës 19.01.2021;
- Kriteret e konkursit për pozitën Udhëheqës Ekzekutiv;
- Vendimi A.nr.266/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- E-mail i datës 17.05.2021 nga z .Arton Smaili;
- E-mail i datës 17.05.2021 nga znj. Sevgi Krasnic;
- E-mail i datës 29.04.2021 nga znj.Shehrie Leci;
- E-mail i datës 29.04.2021 nga z. Arton Smaili;
- Vendim i datës 29.01.2018 për emërimin e Udhëheqësit Ekzekutiv;
- Organogrami i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore e vitit 2010;
- Rregullorja Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore si dhe
- Rregulloren Nr.01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me numër 17/16 të datës 12.05.2016.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck rks-gov net

GJENDJA E FAKTEVE

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka bërë monitorim të jashtëzakonshëm sipas kërkesës se Znj. Eliza Hoxha Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ka kërkuar evidentimin dhe konstatimin nëse ka apo jo shkelje të legjislacionit për shërbimin civil nga ana e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për sa i përket caktimit të Zëvendësuesit të pozitës së Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Kolegji i caktuar për monitorim të jashtëzakonshëm, ka realizuar vizitën e monitorimit të jashtëzakonshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore duke u takuar me Kryetaren e Bordit , Anëtarin e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Zyrtaren e Personelit.

Kolegji i Këshillit gjatë monitorimit të jashtëzakonshëm në këtë institucion, duke u bazuar në bashkëbisedimin me Kryetaren e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Zyrtares se Personelit ka kërkuar informatat si ne vijim:

- Cilën rregullore Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e ka në fuqi Rregulloren Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore apo Rregulloren Nr.01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulture?
- A ka oragnogram për organizimin e vendeve të punës në institucion?
- A është shfuqizuar Rregulloren Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore?
- Në bazë cilës rregullore të brendshme është caktuar zëvendësuesi për vendin e punës Udhëheqësit Ekzekutiv të cilin vendim e keni nënshkruar Ju si Kryetare e Bordit?

Kryetarja e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ka dhënë përgjigjet si në vijim:

- Rregullorja Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk është e shfuqizuar ende është funksionale dhe të gjithë të punësuarit janë të punësuar në bazë të kësaj rregulloreje dhe

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: knmshck rks-gov net

skema organizative është në bazë të kësaj rregullore që janë të planifikuara pesëmbëdhjetë (15) pozita. Mirëpo Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e ka nxjerr edhe Rregulloren Nr.01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me numër 17/16 të datës 12.05.2016 dhe në bazë të kësaj rregullore skema organizative është përcaktuar me gjithsej dyzet e shtatë (47) pozita prej të cilave shtatë (7) pozita janë të anëtarëve të Bordit ndërsa dyzet (40) pozita janë të shërbyesve civil.

- Në bazë të Rregullores Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore e cila është funksionale ka organogram, mirëpo në web faqen e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i vendosur organogrami me pozitat e Rregullores Nr.01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

- Rregullorja Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk është e shfuqizuar.

- Vendimi për caktimin e zëvendësuesit për pozitën *Udhëheqës Ekzekutiv* është nxjerr duke u bazuar në Rregulloren Nr.01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Më tej Kryetarja e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ka theksuar se ka pasur vullnet nga ana e saj për të ftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në monitorim të rregullt pasi që nuk ka njohuri të mjaftueshëm rreth ligjit të shërbimit civil dhe e ka mirëpritur edhe monitorimin e jashtëzakonshëm për çështjen e caktimit të zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv, po ashtu ka theksuar se e kemi pasur të paqartë se si me vepruar në rastin konkret pasi që nga momenti i kompletimit të Bordit është diskutuar lidhur me pozitën e Udhëheqësit Ekzekutiv si dhe parregullsitë që kanë rrjedhë për shkak mos funksionalizimit të Bordit dhe se vazhdimisht Bordi ka bërë përpjekje për zgjidhjen e problemit për këtë arsye me datë 20.01.2022 ka dërguar e-mail tek përgjegjësit e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke kërkuar informata se cilat pozita janë të aprovuara nga Ministria e Administratës Publike për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa me datë 21.01.2022 kemi marrë përgjigje nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se nuk kanë pranuar asnjë kërkesë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për aprovim të pozitave e që nënkupton se nuk ka aprovuar as një pozitë për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck rks-gov net

Kryetarja e Bordit pastaj prezanton e-mail-in e datës 09.09.2021 që ka kërkuar nga Zyrtari i Ligjor që kërkon nga ai një sqarim për pozitën Udhëheqës Ekzekutiv se cilat procedura ligjore duhet t`i ndjekin për emërimin e ushtruesit të detyrës deri në konkurse. Po në të njëjtën ditë zyrtari në fjalë i kthen përgjigje me e-mail Kryetares së Bordit procedurat ligjore për hapjen e konkursit dhe zëvendësimin me ushtrues të detyrës së Udhëheqësit Ekzekutiv, pastaj vazhdon korrespodenca me e-maill ku Kryetarja e Bordit kërkon përsëri sqarim shtesë se cilat nga pozitat të nivelit të mesëm drejtues të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore mund të caktohen si zëvendësues pozita e Udhëheqësit të Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale apo Zyrtar Kryesor Financiar dhe po ashtu në bazë të përshkrimit të vendeve të punës dhe në ëeb faqen e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është edhe një pozitë tjetër zyrtare e nivelit të mesëm drejtues në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore e cila pozitë është Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo materiale dhe se kjo pozitë nuk është e listuar dhe Kryetarja e Bordit njoftohet se kjo pozitë është pozitë e nivelit të ulët drejtues.

Kryetarja e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, prezanton Vendimin me numër 05/2021 të datës 13.09.2021 për caktimin e Z. Kreshnik Bajraktari Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo materiale, caktohet zëvendësues i Udhëheqësit Ekzekutiv me detyra dhe përgjegjësi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net

KONSTATIMET:

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër Akti Nr.05/2021 të datës 13.09.2021 për caktimin e zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ka konstatuar se kjo pozitë është e lirë, dhe se baza juridike e nxjerrjes së këtij vendimi është Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 33 paragrafi 2, ka bërë klasifikimin e pozitave në shërbimin civil, ku ka përcaktuar se: *"Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1.* ***Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme;*** *2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, mbi këtë bazë pozita Udhëheqës Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, hyn në kuadër të kategorisë së lartë drejtuese.

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, konkretisht neni 18 paragrafi 5 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara mbajtësi i pozitës përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, pushim mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, dhe në këto raste mbajtësi i pozitës zëvendësohet përkohësisht nga nëpunësi civil sipas kritereve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore, gjegjësisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Sekretari i Përgjithshëm/Drejtori i Përgjithshëm/Kryeshefi Ekzekutiv, në rast mungesës, zëvendësohet nga drejtori i një prej departamenteve të ministrisë/Agjencisë Ekzekutive/ Agjencisë së Pavarur, i caktuar me shkrim nga vetë Sekretari Përgjithshëm/Drejtori i Përgjithshëm/Kryeshefi Ekzekutiv.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës se përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të bëhet për një periudhe jo me të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck rks-gov net

nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla duhet të behët vetëm përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Këshilli, duke marrë parasysh se kjo pozitë është e lirë, atëherë konstaton se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të kësaj pozite të lirë me zëvendësues duke u thirrur në dispozita te Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson pozitat e nivelit të lartë drejtues Sekretar i Përgjithshëm/Drejtor i Përgjithshëm/Kryeshef Ekzekutiv nuk mund të ushtrohet përmes zëvendësimit sipas procedurave të specifikuar si me lartë, për faktin se në kuptim të dispozitave të nenit 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK)– Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues (tani e ndryshuar me Rregulloren QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues) në rastet e tilla proceduara e konkurrimit duhet të iniciohet tre (3) muaj para së një pozitë të bëhet e lirë. Me tej, në rast se përzgjedhja e zyrtarit të lartë drejtues dështon edhe në procedurën e dytë atëherë deri në plotësimin e pozitës, detyrat e pozitës së lirë kryhen nga nëpunësi i kategorisë së mesme drejtuese me përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil të institucionit siç është paraparë me nenin 40 paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 7 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) – Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ndërsa gjate kësaj periudhe nuk ka gjetur dëshmi se është ndërmarr ndonjë veprim për shpalljen e konkursit për këtë pozitë.

Në rastin konkret duke parë provat e lëndës, Kolegji, konstaton se nëpunës civil i caktuar si Zëvendësues i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës të Trashëgimisë Kulturore sipas Vendimit me numër Akti Nr.05/2021 të datës 13.09.2021, i njëjti në bazë të Akte Emërimit të datës 01.09.2015 mban pozitën Udhëheqës i Divizionit/Programin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo materiale, me çka nënkupton që nuk plotëson kushtin ligjor për të qenë Zëvendësues i pozitës se Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës të Trashëgimisë Kulturore. Ndërsa nga të gjitha provat e marruara rezulton që në kuadër të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk ka pozitë më të lartë se pozita Udhëheqës i Divizionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net

REKOMANDIM:

Nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji rekomandon Kryetaren e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për eliminimin e shkeljeve të konstatuara sipas këtij Raporti, në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira respektivisht pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës të Trashëgimisë Kulturore të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- *Kryetares së Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
ëeb: kpmshck.rks-gov.net